



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.11.2018, ora 09:30

Drejton mbledhjen:

Elisa Spiropali – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëfinancimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë”.

Marrin pjesë:

Elisa Spiropali, Klodiana Spahiu, Ilir Pendavinji, Edlira Bode, Flamur Golemi, Adelina Rista, Arben Kamani, Roland Xhelilaj, Almira Xhambulla dhe Nuri Belba.

Mungojnë:

Petrit Vasili, Vangjel Tavo, Orjola Pampuri, Lindita Metaliaj, Halim Kosova, Bardh Spahia, Floida Kërpaçi dhe Grida Shqina.

Të ftuar:

Mira Rakacolli - Zëvendësministre e Shëndetësisë

Antoneta Njehrrëna – Drejtoreshë Juridike në Ministrinë e Shëndetësisë

Genc Byrazeri – Përfaqësues nga Institut i Shëndetit Publik

Alban Ylli - Përfaqësues nga Institut i Shëndetit Publik

HAPET MBLEDHJA

Elisa Spiropali – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Shëndetësisë.

Sot në rendin e ditës kemi shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëfinancimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë”.

Të ftuar nga Ministria e Shëndetësisë për të bërë prezantimin e projektligjit kemi zëvendësministren, zonjën Mira Rakacolli, zonjën Antoneta Njehrrëna, drejtoreshë Juridike në Ministrinë e Shëndetësisë, zotin Genc Byrazeri dhe zotin Alban Ylli, përfaqësues të Institutit të Shëndetit Publik.

Fjala për ju, zonja Rakacolli, për të prezantuar marrëveshjen.

Mira Rakacolli – Faleminderit!

Ne kemi përgatitur një relacion të detajuar, por unë do të flas shkurtimisht për gjërat kryesore.

Studimi i ADHS-së, për të cilin ne kërkojmë shtimin e financimit, është një studim i madh, i cili ka si qëllim nxjerrjen e disa treguesve shëndetësorë shumë të rëndësishëm për popullatën shqiptare, por edhe përtej saj.

Me anë të këtij studimi ne nxjerrim të dhëna të rëndësishme, siç është mortaliteti infantil i fëmijëve, mortaliteti i nënave, sëmundshmëria për të gjitha grupet e popullsisë deri në moshën 60 vjeç, si dhe konkluzione, që kanë të bëjnë me nivelin e tyre ekonomik, arsimor, shoqëror e të tjerë.

Pra, ky është një studim që, përveçse shkon në drejtim të vlerësimit të treguesve të SDG-së dhe mat zhvillimin e një popullsie, shkon edhe përtej numrave, sepse nxjerr konkluzione se për çfarë arsye janë këta numra. Në bazë e këtyre numrave ne përcaktojmë të gjitha politikat tona shëndetësore dhe sociale. Nga ana tjetër, këta numra mund t’u shërbejnë jo vetëm ministrisë sonë për përcaktimin e politikave, por edhe ministrive të tjera për përcaktimin e politikave të tyre, siç është Ministria e Ekonomisë apo Ministria e Arsimit. Studimin e këtyre treguesve është më i madhi i bërë deri tani dhe përfshin 17 mijë familje në të gjithë Shqipërinë. Më parë, para 10 vjetësh, është bërë një studim, por kishte një kampion shumë më të vogël, sepse përmbante tri qarqe, në një kohë që ky studim përmban të gjitha qarqet. Të dhënat e atij studimi, megjithëse kanë qenë më të vogla, na kanë shërbyer për të bërë politika të tilla madhore, siç janë: strategjia kombëtare e shëndetit, programet që kanë të bëjnë

me shëndetin riprodhues, programet që kanë të bëjnë me parandalimin e sëmundjeve infektive dhe të atyre joinfektive. Kështu që besoj se ka më shumë informacione pse është kaq i rëndësishëm ky studim.

Metodologjia e këtij studimi është shumë bashkëkohore jo vetëm europiane, por edhe më tej. Për këtë arsye financimi i këtij studimi është mbështetur nga organizata të rëndësishme, siç janë: UNFPA-ja, UN Women, si dhe ambasada zvicerane me anë të projektit “Shëndet për të gjithë”, e cila prej disa kohësh vazhdon në Shqipëri.

Duke qenë se financimi i këtij studimi ka të tillë partnerë, ka dalë problemi i ndryshimeve në kursin e këmbimit valutor të monedhave si franga zvicerane apo dollari, sepse që studimi të realizohet plotësisht kërkon një vlerë, që shkon deri në 300 mijë dollarë amerikanë.

Për vlerën që ka ky studim për Ministrinë e Shëndetësisë dhe përcaktimin e saktë të politikave të saj, ne mendojmë se është e justifikuar dhe do të përballohet e gjitha nga buxheti i ministrisë, pra nuk do të kërkohej një buxhet tjetër shtesë për financimin e këtij studimi. Vlen të përmendet se ne nuk do ta financojmë të gjithë këtë studim, por vetëm 2/3-en e tij, sepse 1/3-ta do të financohet nga UNFPA-ja, e cila, përveç angazhimit që ka në këtë studim, ka parë të arsyeshme edhe një angazhim plus, pra të na përkrahë financiarisht.

Jam e hapur për çfarëdolloj pyetjeje që do të keni.

Gjithashtu, këtu janë prezentë edhe teknikët që janë marrë me këtë studim dhe ndoshta mund të na thonë më shumë gjëra të detajuara.

Elisa Spiropali – Faleminderit, zonja Rakacolli!

Kush ka pyetje?

Po, zonja Rista.

Adelina Rista – Faleminderit, zonja Rakacolli, për paraqitjen tuaj!

Unë do t’ju bëj vetëm një pyetje të thjeshtë. Me anë të këtij projektligji i jemi afruar përfundimit të këtij studimi. Kur themi “përfundimit të studimit” do të thotë se ky studim ka nisur dhe është në vazhdimësi. Unë dua të di: a ka një afat se kur do të mbarojë ky studim?

Mira Rakacolli – Me sa di, studimi tashmë ka mbaruar, sepse është bërë edhe përpunimi paraprak i rezultateve, megjithatë deri në fund të vitit 2018 ne do ta botojmë, të paktën unë kështu e di.

Alban Ylli – Raporti përfundimtar do të përfundojë brenda vitit dhe më pas do të linçohet.

Adelina Rista – Faleminderit!

Elisa Spiropali – A ka ndonjë gjë tjetër për të shtuar?

Genc Byrazeri – Zonja zëvendësministre i tha të gjitha, por unë dua të shtoj se në vitin 2020 skadon strategjia aktuale e Ministrisë së Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale. Natyrisht, kjo strategji duhet përshëndetur dhe duhet pritur strategjia e radhës. Ky është momenti më i mirë për të ushqyer strategjinë e re të shëndetësisë në zona të reja.

Ilir Pendavinji – Kur ka përfunduar kjo strategji?

(Diskutime pa mikrofon.)

Genc Byrazeri – Kjo do të skadojë pas një viti e gjysmë ose pas dy vjetësh dhe, më pas, ekspertët e Organizatës Botërore të Shëndetësisë do të kontaktojnë menjëherë me ministrin e Shëndetësisë për të krijuar grupin e punës. Ky është momenti ideal që ta forcojmë strategjinë e re, e cila është në linjë me “Axhendën 2020”, shëndet për të gjithë e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, rajonin europian. Gjithashtu, është në linjë me “Axhendën 2030” me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe në linjë me diçka tjetër shumë të rëndësishme, sepse Ministria e Shëndetësisë, prej kohësh tashmë ka shpallur si prioritet sëmundjet jo të transmetueshme.

Për herë të parë ky studim global për sëmundjet jo të transmetueshme, parashikon të gjithë indikatorët, që ne do të ushqejmë nëpërmjet këtij studimi. Më falni për entuziazmin e këtij studimit, por më duhet të them se për herë të parë në Shqipëri do të kemi të dhëna në nivel qarku, madje edhe rrethi, sepse një nga kritikët konsultativë e të gjithë donatorëve ishte se kur ne i flisnim për termat globale për Shqipërinë, ata nuk i dinin se cilat ishin rajonet më të disfavorizuara. Kjo është me rëndësi jetike jo vetëm për ministrinë tonë, por edhe për INSTAT-in, sepse vërtet është përdorues i të dhënave, por studimi ka një komponent shumë të fortë demografik, pasi ne marrim të dhëna shumë të çmuara për fertilitetin.

Qeveria shqiptare ka nisur një nismë shumë të mirë për inkurajimin e lindjeve, pra do të jepen bonuse për lindjen e fëmijës së parë, të dytë dhe të tretë. Për herë të parë ne kemi një studim shumë të mirë në popullatë, ku do të kemi një vlerësim real të indeksit sintetik të fertilitetit.

Lidhur me nivelin e arsimit, ne jemi futur në 17 mijë familje shqiptare për të parë nivelin e arsimit, sa vite shkollë ndiqen, si dhe nivelin e papunësisë, Pra, ne jemi mirinformuar jo thjesht për vlerësimet shumë të mira që bën INSTAT-i, por kemi pretenduar që, me anë të këtij studimi, të prekim me dorë të gjithë realitetin në Shqipëri. Më falni që u zgjata, por realisht kemi të bëjmë me një mega studim, siç e tha edhe zonja Rakacolli, i cili informon jo thjesht ministrinë tonë, por edhe ministrinë e tjera, organizmat kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon.)

Elisa Spiropali – Në kushtet aktuale në çfarë niveli i keni bërë ju këto studime?

(Diskutime pa mikrofon.)

Alban Ylli – Si ky studim nuk ka të tjerë në Shqipëri, sepse janë jashtëzakonisht shumë të pjesshëm, pra mund të jenë bërë vetëm në Tiranë. Këto studime lidhen shumë me kostot dhe me logjistikën. Në mënyrë klasike Instituti i Shëndetit Publik bën studimin e shkollave, pra ne mund të bëjmë periodikisht studime në shkolla.

Elisa Spiropali - Pra, janë të izoluara.

Alban Ylli – Janë për grupmosha të ndryshme, sepse ne jemi futur në shtëpitë e njerëzve dhe ky është rasti i parë që është bërë në mënyrë masive.

Adelina Rista - Pra, ky studim prek 17 mijë familje në të gjithë Shqipërinë?

Genc Byrazeri – Me këtë studim realiteti preket me dorë, vlerësohen kushtet social-ekonomike, shëndetësore, aksesit në ujë e pijshëm, elektriciteti, ngrohja e të tjerë.

Mira Rakacolli – Ky studim është bërë me 17 familje kompiute dhe ka një metodologji që i përfaqëson të ndara këto familje. Në një numër të tillë ti mund t'i përgjithësosh të dhënat, por, për shembull, në 5 familje nuk mund të nxjerrësh të dhëna për 20 mijë familje, kurse kjo nga ana statistikore...

Adelina Rista – Për shembull, nëse dikush merr në telefon dhe thotë se duan të vijnë të matin ndotjen e ujit në familje, janë të këtij studimi, apo jo?

(Diskutime pa mikrofon.)

Arben Kamami – Cili institucion është marrë me këtë studim?

Genc Byrazeri – Është marrë Instituti i Statistikave dhe Instituti i Shëndetit Publik....

(Diskutime pa mikrofon.)

Roland Xhelilaj – Unë kam disa pyetje, duke u nisur edhe në vazhdimin e atyre që thanë kolegët. Nga mënyra e ndërtimit ky studim tregon se është gjithëpërfshirës. Për çfarë shërben ky studim në vazhdim? A mos ndoshta është teoria që herë pas here të bëjmë studime kaq të thella dhe t'i konsiderojmë si studime shumë të mira, apo këto studime krijojnë një bazë të domosdoshme, që pjesa politike e studimeve të ministrisë të ketë mbështetje në vazhdimësi?

Mira Rakacolli – Ky studim bëhet pikërisht për këtë gjë, sepse nuk mund të ndërtosh një politikë në qoftë se nuk i ke numrat. Prandaj unë e thashë që ky studim shkon përtej numrave. Pra, nëse unë shikoj që në një familje lindin fëmijë prematurë, me anë të këtij studimi unë e kuptoj pse ndodh kjo gjë, sepse njëkohësisht unë shikoj edhe gjendjen sociale-ekonomike, shikoj edhe nivelin e arsimit, shikoj edhe nivelin e punësimit dhe kuptoj se në këtë drejtim duhet të fokusoj më shumë politikat e mia shëndetësore. Kjo bëhet njëkohësisht edhe

ministritë e tjera për politikat e tyre arsimore apo financiare të punësimit e të tjerë. Pra, ky është thelbi i këtij studimi, i cili i vlen vendit.

Genc Byrazeri – Ky studim është sigurimi më i mirë për ministrinë dhe është llogaridhënie.

(Diskutime pa mikrofon.)

Mira Rakacolli – Për shembull, Banka Botërore paraqiti një studim për kapitalin njerëzor për arsimimin. Ky studim ishte bazuar në disa të dhëna të studimit të viti 2008, i cili nxirrte që Shqipëria ishte në një nga vendet me nivelin më të ulët në zhvillimin e fëmijëve 0-5 vjeç dhe e lidhte këtë gjë me arsimin. Në të njëjtën kohë nga të dhënat paraprake që kemi ne, duke marrë parasysh edhe të dhënat e atij studimi, ne bëjmë politika të shëndetshme, për shembull, Ministria e Shëndetësisë bëri politika shëndetësore. Ky studim tregon se ka qenë progres dhe politikat tona kanë qenë të efektshme dhe duhet të vazhdojnë në atë drejtim. Pra, kjo është në gjë që vlen.

Klodiana Spahiu – Ky studim është shumë i rëndësishëm. Studimi i parë ka filluar në vitet 2008-2009 dhe duke qenë se ju jeni specialistë shumë të vjetër, e kam fjalën për dy kolegët e ISHP-së, jeni si një kompjuter i ISHP-së, sepse keni një memorie të thellë. Mbledhja e sotme është shumë e shkurtër për arsye se ne duhet të shkojmë në parlament, por rëndësia e imponimit të anëtarëve të komisionit për këtë marrëveshje në lidhje me çfarë është bërë që nga viti 2008, si dhe rëndësia e këtij studimi, përtej informacionit që ne kemi nga marrëveshja, është për të ditur, ashtu siç ju e thatë, se çfarë përfiton jo vetëm sektori i shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, por të gjithë sektorët e tjerë në lidhje me këtë marrëveshje dhe me këtë studim, sepse ju e keni filluar punën prej 10 vjetësh. Pra, kjo është çështje financiare dhe nuk ka të bëjë me shëndetësinë, por e mira do të ishte që edhe ne të kishim një informacion më të detajuar në lidhje me çfarë është arritur, cilat kanë qenë objektivat dhe si i shërbejnë këto Ministrisë së Shëndetësisë. Të them të vërtetën janë bërë shumë gjëra, por informacioni është pak i mangët. Pra, ne duhet të dimë se si ta ndajmë këtë informacion, sepse një gjë e tillë është bërë edhe më parë, por një studim i tillë nuk është bërë ndonjëherë.

Elisa Spiropali - Ju lutem, mund të flisni shumë shkurt, pasi ne duhet të shkojmë në seancë në orën 10:00.

Klodiana Spahiu – Nuk ka problem, sepse një informacion më të detajuar mund të na e sjellin edhe më pas.

Elisa Spiropali - Kjo që tha zonja Spahiu është shumë e rëndësishme, pasi relacioni nuk i afrohet asaj që ne po diskutojmë dhe nuk kuptohet qartë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Flamur Golemi – E mira do të ishte që ne të mbledhemi për një seancë dëgjimore.

Elisa Spiropali - Pas buxhetit ne mund të bëjmë një seancë dëgjimore ose një vizitë në ISHP për ta parë nga afër.

E hedhim në votë në parim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëfinancimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë”.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2 “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren Zyrtare””. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim në votë në tërësi projektligjin.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Projektligji miratohet edhe në tërësi.

Faleminderit juve dhe kolegëve!

MBYLLET MBLEDHJA